

të Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Përgjatë këtij harku kohor në Klinikën e Ligjit janë përcjellë dhe janë trajtuar 132 ankesa në total. Ndaj tyre, KShH ka realizuar një sërë shërbimesh, si këshillim ligjor falas, ndërhyrje në institucione shtetërore, verifikim në vend, përfaqësim gjyqësor, etj., gjithnjë pa veçuar reagimin publik.



Dominojnë ankuesit e rritur meshkuj me 85% të totalit, ndërsa përsa i përket kombësisë së ankuesve vetëm 3% e ankesave janë drejtuar nga persona të pakicave kombëtare.


Më së shumti ankesat lidhen me shkeljen e të drejtave në sistemin penicitar me 56% të totalit. Pranë Klinikës janë adresuar dhe ankesa të natyrës civile, të cilat përfaqësojnë 26% të totalit.

Në pjesën më të madhe të shqetësimeve të adresuara nga qytetarët është trajtuar ankesa e përcjellë prej tyre (e 52% të rasteve në total si dhe është ofruar këshillim ligjor në 38% të rasteve.

në harkun kohor Korrik-Dhjetor 2023

Përsa i përket shtrirjes gjeografike rreth 44% e ankesave janë përcjellë nga Burrel, i cili rezulton qyteti me më shumë ankues, ndjekur nga Tirana me 20% dhe Lezha me Shkodrën me 6% respektivisht.

65% e ankesave janë drejtuar nga shtetas të cilët ndodhen në institucionet penicitare dhe 32% nga shtetas në gjendje të lirë.



Dominojnë ankesat me objekt cënimin e nenit 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjaret) dhe nenit 6 të KEDNJ-së (NE drejta për një proces të rregullt), me 23% dhe 12% të totalit.

Vijon të jetë problematike situata përsa i përket respektimit të së drejtës së informimit ku rreth 12% e ankesave të administruara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit kanë pasur si objekt